



Tirane me, date 2.08.2016

NJOFTIM

Të nderuar stazhierë,

Ju Njoftojmë se mbështetur në nenin 15 të Ligjit 10091 datë 5.03.2009 “Për auditim Ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) :*praktika profesionale për stazhierët e rinj do të kryhet në kushtet e punësimit me kohë të plotë për një periudhë 3-vjecare si dhe të nenit 59, pika 9 sipas të cilit : Stazhierët , te cilët e kanë filluar praktikën profesionale përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, vijojnë me procedurat e praktikës profesionale, të parashikuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.*

Këshilli Drejtues i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), i mbledhur më datë 2.08.2016 me Vendim Nr 34 dt 02.08.2016 vendosi si me poshtë :

- Për të qënë në pajtim me nenin 59 pika 9 të Dispozitave kalimtare të ndryshimeve të Ligjit të Auditimit Ligjor, por edhe me frymën e ndryshimeve të këtij Ligji të përcaktuara në Nenin 15 për kryerjen e praktikës profesionale në kushtet e punësimit me kohë të plotë për një periudhë 3-vjecare , ndryshimet e Kontratës së stazhit do te bëhen vetëm në rastet kur stazhierët kërkojnë të kryejnë stazhin me kontratë punësimi me kohë të plotë me afat 3-vjecar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

IEKA